



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË  
PËRGJITHSHËM SHKODËR

**URDHËR**

**NR. 14 , DATË 29.05.2023**

**“PËR  
MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT PËR MASAT ADMINISTRATIVE DHE  
PROCEDURALE NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË  
PARË SHKODËR  
PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të neneve 148, 148/b e vijues të “Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë”, si dhe në neneve 21, 38, 42 shkronja “a” e vijues të ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore” i ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2023”, si dhe Urdhërit nr.70 datë 12.05.2023 “Për miratimin e planit të veprimit për zbatimin e “Rekomandimeve Prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023” të Prokurorit të Përgjithshëm.

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Planit të Veprimit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, për zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”, sipas tekstit bashkëlidhur vendimit.
2. Për zbatimin e masave të “Planit të Veprimit” ngarkohen Drejtuesit e Seksioneve, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të të gjitha strukturave, Kryesekretarja, Shefja e Financës, si dhe nëpunësit e prokurorisë në të gjithë nivelet.
3. Në ecurinë e zbatimit të masave të këtij plani veprimi, Drejtuesit e Seksioneve të Prokurorisë shqyrtojnë dhe kujdesen:

- i. të ndjekin, koordinojnë dhe monitorojnë në vazhdimësi zbatimin e masave/aktiviteteve në përputhje me afatet e percaktuara në planin e veprimit;*
  - ii. të raportojnë për statusin e masave sipas fushës së përgjegjësisë së strukturës që drejtojnë;*
  - iii. të ndërhyjnë dhe koordinojnë veprimet kur masat rezultojnë të pazbatuara;*
  - iv. t'i raportojnë Drejtuesit të Prokurorisë me shkrim, çdo muaj për realizimin e masave dhe/ose aktiviteteve dhe sa herë kërkohet, për realizimin e masave dhe/ose aktiviteteve.*
4. Me kërkesë të Drejtuesve të Seksioneve, ose kryesisht, Drejtuesi i Prokurorisë mund të thërrasë mbledhje të drejtuesve apo prokurorëve për të vlerësuar ecurinë e zbatimit të masave të këtij plani veprimi.
  5. Drejtuesi i Prokurorisë, periodikisht çdo 3 (tre) muaj, dhe sa herë kërkohet, si dhe nëpërmjet raportit vjetor mbi ecurinë e punës së prokurorisë, informon Prokurorin e Përgjithshëm, për masat administrative dhe procedurale të marra për zbatimin e kërkesave të Rekomandimeve prioritare të Këshillit të Ministrave, të shoqëruar me treguesit statistikorë të saktë e analitik dhe me shpjegime të qarta mbi angazhimet, arritjet e problematikat, si dhe me vlerësimin si ka ndikuar zbatimi i kërkesave të rezolutës mbi gjendjen e kriminalitetit dhe performancën e prokurorisë.
  6. Me këtë urdhër të njihen prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve dhe strukturave hetimore në shërbimet e policisë gjyqësore, si dhe nëpunësit e prokurorisë në të gjithë nivelet.
  7. Një kopje e këtij urdhëri i'u komunikohet nëpërmjet postës elektronike zyrtare @pp.gov.al.
  8. Një kopje e këtij urdhëri i dërgohet Prokurorisë së Përgjithshme për njoftim dhe publikim në faqen zyrtare.
  9. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

## DREJTUESI I PROKURORISË

**ALBERT MURÇAJ**





## **PLANI I VEPRIMIT**

### **PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE PRIORITARE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN 2023**

Me qëllim për të njëzuar ndjekjen dhe zbatimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.226, datë 13.04.2023, “Për miratimin e rekomandimeve prioritare në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2023”, në kompetencë lëndore të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, me objektiv përcaktimin e masave administrative dhe procedurale që duhet të merren për realizimin e prioriteteve që sigurojnë zbatimin, hartohet ky plan veprimi.

#### **I. GARANTIMI I PAVARËSISË DHE I PËRGJEGJSHMËRISË SË PROKURORIT**

- Brenda 3 muajve të merren masa për rritjen e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak nga secili prokuror i kësaj prokurorie, në funksion të shtimit të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, duke ju kërkuar secilit prokuror që në rastet që ata marrin dijeni nga publiku, nga media apo informacionet që ata mund të administrojnë për shkak të funksionit apo gjatë ushtrimit të detyrës të tregohen sa më aktivë për fillimin kryesisht të hetimeve.
- Në vijimësi të merren masa për garantimin e paanshmërisë dhe shmangien e çdo lloj influence ose ndikimi ndaj prokurorit gjatë kryerjes së hetimeve, duke i inkurajuar prokurorët që të raportojnë pa asnjë hezitim rastet kur ndaj tyre është ushtruar ndonjë influencë apo ndikim i kundraligjshëm.
- Në vijimësi, në kuadër të forcimit të mekanizmave të kontrollit dhe të llogaridhënies së prokurorit, nga Drejtuesi i Prokurorisë nëpërmjet kërkesave për informacion dhe udhëzimeve jo detyruese do të mundësohet kontrolli sipas parashikimeve ligjore, si dhe në rast se konstatohen shkelje të rënda do të informohen ILD-ja, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm, kjo dhe në kuadër të zbatimit e monitorimit të udhëzimit të përgjithshëm të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin, transparencën dhe garantimin e pavarësisë, në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.
- Prokurorët të ushtrojnë kontroll efektiv periodikisht në punën e OPGJ-ve, duke i inkurajuar ata që të evidentojnë rastet që duhen proceduar në rrugë disiplinore për shkak të zvarritjeve dhe mungesës së dilijencës në përmbushjen e detyrave që u ngarkon ligji.

- Brenda muajit shtator 2023, të evidentohen shqetësimet dhe vështirësitë që hasin prokurorët dhe/ose oficerët e policisë gjyqësore të kësaj prokurorie lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave të reja të ligjit penal e procedural penal, metodikat/protokollet e hetimit për vepra ose grupvepra penale dhe më pas, të organizohen trajnime të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve, duke ia paraqitur këto shqetësime Prokurorisë së Përgjithshme dhe Shkollës së Magjistraturës për të mundësuar trajtimin e tyre në programet e trajnimeve vazhduese, si dhe në vazhdimësi të merren masa për rritjen profesionale dhe organizimin e trajnimeve për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, në fusha specifike, sipas ndarjes së tyre në seksione brenda prokurorisë,
- Në vijimësi të identifikohen problemet dhe të merren masa konkrete për përmirësimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve” (CAMS), duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtorinë e IT-së dhe Drejtorinë Ekonomike dhe Financës në Prokurorinë e Përgjithshme, me qëllim rishikimin dhe mirëfunksionimin e sistemit elektronik të ndarjes së çështjeve, për sa i përket mënyrës së disponimit për çështje konkrete, gjykimet e posaçme, pasqyrimin e saktë të të dhënave në sistemin CAMS në të gjitha fazat e procedimit penal, si dhe kontrolli i vazhdueshëm mbi hedhjen dhe administrimin e paraqitjen e këtyre të dhënave.

## **II. LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT**

- Në vijimësi të rritet cilësia e hetimeve për veprat penale në fushën e korrupsionit që janë kompetencë lëndore e Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, përfshirë përdorimin me efikasitet të teknikave proaktive të hetimit, për aq sa është e mundur, si dhe duke rritur numrin e personave të hetuar dhe të dërguar për gjykim për këto vepra penale, si dhe ndjekjen me vendosmëri të kërkimeve për dënimin e autorëve të këtyre veprave.
- Të vijojë të rritet numri i hetimeve proaktive pasurore dhe financiare, veçanërisht për rastet që lidhen me veprat penale në fushën e korrupsionit në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie.
- Brenda 3 muajve të evidentohet shtimi i numrit të hetimeve proaktive me qëllim përmirësimin e cilësisë së hetimeve të veprave kundër korrupsionit, në kompetencë lëndore të kësaj prokurorie.
- Të vijojë shtimi i numrit të hetimeve financiare dhe sistematike pasurore dhe hetimit për veprat penale që gjenerojnë produkte/të ardhura, si dhe shtimi i aseteve të sekuestruara/konfiskuara, duke përfshirë rastet e tjetërsimit të tyre nga persona të tretë.
- Të vijojë rritja e bashkëpunimit me Prokurorinë e Posaçme në lidhje me rastet e veprave penale në këtë fushë dhe ndarjen e kompetencave për veprat penale në fushën



e korrupsionit dhe me qëllim garantimin e efektivitetit dhe shpejtësisë në hetimin e çështjeve.

- Të vijojë shtimi i numrit të hetimeve të çështjeve të filluara kryesisht, si dhe vijimi i shtimit të hetimeve proaktive me përdorimin më të gjërë të mjeteve të posaçme të hetimit, me qëllim përmirësimin e cilësisë së hetimeve.
- Të vijojë zhvillimi i kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër korrupsionit me agjencitë e zbatimit të ligjit, si dhe me oficerët e policisë gjyqësore.
- Të vijojë të ndiqen me përparësi kallëzimet/çështjet penale që kanë të bëjnë me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, duke kryer hetime të plota, të paanshme, të shpejta, me profesionalizëm dhe me efektivitet, në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe Prokurorinë e Posaçme (SPAK-un).

### **III. LUFTA KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR**

- Në vijimësi dhe brenda 3 muajve të evidentohet rritja e bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet strukturave të prokurorisë, policisë gjyqësore, policisë së shtetit dhe agjencive të tjera shtetërore, për zbatimin e objektit dhe qëllimin e ligjit për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike.
- Brenda 3 muajve të evidentohet rritja e numrit të procedimeve penale të regjistruara dhe të dërguara për gjykim për veprat penale në fushën e narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme, si dhe ashpërsimin e politikës së dënimit dhe masave të sigurimit personal për këto vepra penale.
- Të vijojë përmirësimi i cilësisë së hetimeve për veprën penale të pastrimit të produkteve të veprës penale dhe atë të pastrimit të parave në funksion të rritjes së numrit të çështjeve dhe të pandehurve të dërguar për gjykim dhe përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore.
- Të vijojë fuqizimi i bashkëpunimit ndërkombëtar nëpërmjet hartimit në kohë të letërporosive, në funksion të rritjes së cilësisë dhe efektivitetit të hetimeve.
- Të vijojë zbatimi i masave për përmbushjen e rekomandimeve të Moneyval për pastrimin e parave, luftimin e financimit të terrorizmit, të bashkëpunimit me Eurojust (*kthimit të përgjigjeve në kohë të letërkërkesave të Eurojust*), si dhe të bashkëpunimit rajonal në fushën e trafikimit të qënieve njerëzore, etj.
- Të vijojë zbatimi i masave në drejtim të rritjes së rasteve të përdorimit të teknikave speciale të hetimit, veçanërisht në rastet e hetimeve pasurore, por edhe në rastet e trafikimit dhe krimit të organizuar.

- Vijimin e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional me strukturat e prokurorive të tjera të juridiksionit të përgjithshëm dhe me Prokurorinë e Posaçme, me policinë gjyqësore, policinë e shtetit dhe agjencitë e tjera shtetërore, në lidhje me zbatimin e masave parandaluese në kuadër të forcimit të luftës terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit dhe sigurisë publike.
- Të vijojë zhvillimi i kapaciteteve profesionale për prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me fokus në luftën kundër krimit të organizuar me agjencitë e tjera të zbatimit të ligjit, si dhe me oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve.
- Vijimin e plotësimit dhe mbikqyerjen e sistemit statistikor të monitorimit të çështjeve të pastrimit të parave dhe asetëve të sekuestruara e-tracking PRESTO, për të siguruar tregues efektivë dhe të matshëm të punës së kryer në hetimin, ndjekjen penale dhe dënimin për këto vepra penale.

#### **IV. FORCIMI I RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË NJERIUT**

- Në vijimësi të aplikohen masat alternative të parashikuara nga Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur (Shmangies) tek të miturit, për të siguruar një drejtësi miqësore dhe duke mbajtur në konsideratë interesin më të lartë të të miturit.
- Të vijojë shtimi i numrit të rasteve të zbatimit të instrumenteve lehtësuese penale (marrëveshje, urdhri penal) dhe rritja e rasteve të gjyqimit të drejtpërdrejtë, me synim hetimin dhe gjykimin e çështjeve penale në një afat sa më të shpejtë, duke mbajtur në konsideratë kompleksitetin, rrezikshmërinë e veprës, kjo duke ruajtur efikasitetin dhe cilësinë e hetimeve.
- Në vijimësi të synohet rritja e aplikimit të dënimeve alternative në rastet e veprave penale dhe/ose autorëve me rrezikshmëri të ulët shoqërore, veçanërisht në rastet e të miturve, personave vulnerabël dhe personave me probleme shëndetësore.
- Të vijojë ashpërsimi i masave të sigurimit dhe masës së dënimit për veprat me natyrë gjinore, seksuale dhe diskriminuese, si dhe për rastet e keqtrajtimit/abuzimit/shfrytëzimit e trafikimit të fëmijëve.
- Në vijimësi të synohet rritja e cilësisë së hetimeve dhe gjyqimit për autorët e veprave penale në fushën e mjedisit.
- Të vijojë zhvillimi i kapaciteteve profesionale të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore nëpërmjet trajnimeve veçanërisht për veprat penale me bazë gjinore, seksuale dhe përfshirjen e të miturve, krimin kibernetik dhe veprat penale mjedisore.
- Marrjen e masave për rritjen e efektivitetit të garancive procedurale për viktimat e mitur dhe zbatimin e parashikimeve ligjore të Kodit të Drejtësisë Penale për të miturit në konflikt me ligjin.



- Rritjen e përpjekjeve dhe ashpërsimin e masave për të forcuar luftën kundër krimit në familje dhe dhunës ndaj grave, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e këtyre fenomeneve të dëmshme për shoqërinë shqiptare.
- Vijimin e rritjes së cilësisë së hetimeve dhe ashpërsimin e politikës penale duke rritur kërkesat e caktimit të dënimit me burg për autorët e veprave penale të dhunës në familje dhe kryesisht autorët recidivistë të dhunës në familje.

## **V. FORCIMI I BASHKËPUNIMIT NDËRINSTITUCIONAL**

- Shtimin e çështjeve të rregjistruara dhe të dërguara për gjykim, për grup veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, duke forcuar bashkëpunimin me institucionet përkatëse në luftën kundër informalitetit dhe ndaj subjekteve që priren të kryejnë evasion fiskal dhe ndaj nënpunësve publikë të administratës tatimore dhe doganore.
- Të vijojë rritja e numrit të hetimeve paralele financiare në lidhje me veprat penale në fushën e taksave dhe tatimeve, si vepra penale që gjenerojnë të ardhura, gjurmimin e produkteve dhe rritjen e numrit të sekuestrimeve/konfiskimeve.
- Të ndiqen me përparësi kallëzimet dhe çështjet penale që kanë të bëjnë me veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve, duke kryer hetime të plota, të paanshme, të shpejta, me profesionalizëm dhe me efektivitet, në bashkëpunim me të gjitha agjencitë ligjzbatuese dhe Prokurorinë e Posaçme (SPAK-un).
- Shtimin e rasteve të hetimit të veprave penale që lidhen me krimin kibernetik, thelbësore si pjesë e masave për sigurinë kibernetike të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave.
- Vijimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim rritjen e cilësisë dhe efikasitetit në hetimin dhe ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe shkëmbimin e të dhënave në funksion të hetimit të specializuar, të shpejtë dhe të gjithëanshëm.
- Shtimin e numrit të hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e krimeve financiare, pastrimit të parave, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore, si dhe për veprat penale në fushën e krimeve të rënda që mund të lidhen me format e veçanta të bashkëpunimit.
- Vijimin e forcimit të kapaciteteve të seksionit të posaçëm kundër pastrimit të parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore me qëllim rritjen e numrit dhe cilësisë së hetimeve për veprat penale në kompetencë të këtij seksioni.
- Vijimin e rritjes së rasteve të kryerjes së veprimeve të përbashkëta hetimore me oficerët e shërbimeve të tjera të policive gjyqësore, sidomos për rastet e referuara në prokurori prej tyre.

- Vijimin e zhvillimit të kapaciteteve profesionale nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta me oficerët e policive gjyqësore në drejtim të ligjshmërisë së veprimeve hetimore dhe vlerës së provave, veçanërisht në rastet e hetimeve financiare, evazionit fiskal dhe krimit kibernetik.